



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 842/1 Prot.

Tiranë, më 17.03 2023

V E N D I M

Nr. 39 dt. 17.03 2023

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.44 DATË 26.04.2022 TË SENATIT AKADEMIK
“PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR
KONKURS, REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË, TË
TRETË TË STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË TRE CIKLET E
STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të pikës 3/ç, nenit 3, nenit 6, pika 28, 29, 30, nenit 38, nenit 76, nenit 84, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, nenit 20, pika 7/ç, nenit 75 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së; Vendimit nr.44 datë 26.04.2022; Senati Akademik, në mbledhjen e datës 17.03.2023

V E N D O S I:

1. Të miratojë reduktimin e tarifës normale për programin e studimit Master Profesional në “Trajner i Përgatitjes Fizike” për vitin akademik 2022-2023 si vijon:
 - Për program të parë studimi nga 65.000 lekë në 32.500 lekë
 - Për program të dytë studimi nga 75.000 lekë në 37.500 lekë(Referuar Tabelës 4 bashkëngjitur Vendimit nr.44 datë 26.04.2022 të Senatit Akademik, bashkëngjitur)
2. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim i përcillet për publikim Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 686/3 prot.

Tiranë, më 26.04 2022

V E N D I M

Nr. 44 datë 26.04 2022

**“PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS,
REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË, TË TRETË TË
STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË TRE CIKLET E
STUDIMEVE,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS “**

Në zbatim të pikës 3 /ç, neni 3, neni 6, pika 28, 29, 30, neni 38, neni 83, neni 85 të Ligjit nr.80/2015”Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, Statutin e UST, Rregulloren e UST, në VKM nr. 288 datë 21.05.2018” Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plotë”, në Urdhërin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 “Për hapjen e njësisë kryesore ”Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Urdhërit nr. 245 datë 22.07.2020”Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë ”Bachelor” në Shkenca të Rehabilitimit” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, të VKM nr. 778, dt. 26.12.2018; VKM nr. 779 dt. 26.12.2018 ” Për disa ndryshime në VKM nr. 269, dt.29.03.2017 ”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” te ndryshuar”, VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 ”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike”, në Udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 ‘Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e Arsimit të Lartë”, Urdhërin e Ministres nr 355 datë 17.09.2021 ”Për hapjen e Programit të studimit të ciklit të dytë ”Master

profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike , në Universitetin e Sporteve të Tiranës, shkresën nr. 1196 datë 22.02.2022 "Mbi përcaktimin e udhëheqëve për programet e ciklit të tretë doktoratë", shkresën nr. 1273.1 datë 25.02.2022 "Dërgohet urdhëri për njohje dhe zbatim" , shkresën nr. 1196/3 datë 25.02.2022 "Për riorganizimin e programit të të ciklit të tretë doktoratë në Aktivitet fizik dhe shëndeti në UST", shkresën nr. 1273/1 datë 25.02.2022"Dërgohet urdhëri për njohje dhe zbatim", në Urdhërin nr. 95 datë 25.02.2022"Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Shkenca Sportive në UST" në Vendimin e Senatit nr. 20 datë 11.03.2022 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2021-2022", Senati në mbledhjen e datës 26.04.2022,

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin për tarifën e regjistrimit në konkursin praktik të aplikantëve (FShL,FVFR) dhe tarifën e regjistrimit të fituesve (FShL,FVFR,FShR) për ciklin e parë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave bashkëngjitur .
2. Tarifën e regjistrimit në konkurimin praktik të aplikantëve, tarifën e aplikimit dhe tarifën e regjistrimit të fituesve të kandidatëve nga trojet, kandidatëve me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian në programet e ciklit të parë, transferim studimesh dhe program të dytë studimit, për vitin akademik 2022-2023, janë të njëjta me tarifën , për ciklin e parë të studimeve.
3. Tarifën e aplikimit të kandidatëve, kandidatëve për transferim studimesh e të tjerë dhe tarifën e regjistrimit të fituesve për ciklin e dytë të studimit(program i parë/ program i dytë), për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave bashkëngjitur .
4. Të miratojë propozimin për tarifën e shkollimit për ciklin e parë të studimeve bachelor, për të gjithë programet e studimit, për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave bashkëngjitur.
5. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
6. Studenti që i mbetet vetëm provimi i formimit dhe nuk është i detyruar të ndjekë studimet gjatë vitit akademik 2022-2023, duhet të paguajë vetëm tarifën për kreditet e mbetura.
7. Studentët të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6(gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti 2022-2023 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit, sipas tabelës bashkëngjitur, ndërsa studentët me mesatare mbi 6 paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit, pjesa tjetër rimbursohet nga fonde grand të buxhetit të shtetit.

8. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve dhe rezultojnë me mesatare vjetore 9(nëntë) deri në 10(dhjetë) duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.
9. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik me notë mesatare vjetore 9(nëntë)-10(dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlllogaritur si mesatare të notave të të gjithë viteve të arsimit të mesëm të lartë , përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore sipas listës së sjellë nga QSHA, përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023.
10. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.
11. Kandidatët/aplikantët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe, në këtë rast, aplikantët fitues përballojnë koston e plotë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
12. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në këto programe studimi, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgon për çdo vit listën e studentëve të huaj që përfitojnë nga marrëveshjet zyrtare shtetërore.
13. Të miratojë propozimin për tarifën e shkollimit për studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave bashkangjitur dhe e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste.
14. Studentët të cilët nuk kanë përfunduar programin përkatës të studimit të ciklit të dytë apo nuk kanë shlyer të gjithë provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë tarifën për kredit të parashikuar sipas këtij vendimi.
15. Studentët e ciklit të dytë sipas shtresave në nevojë, studentët që vijnë nga cikli i parë i studimeve me notën mesatare 9-10 dhe studentët që vazhdojnë studimet në ciklin e dytë në vitin pas të parit dhe kanë shlyer të gjithë detyrimet akademike për vitin akademik paraardhës me mesatare të vitit paraardhës 9-10, përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit.

16. Studentët e ciklit të parë dhe të dytë që plotësojnë kriteret për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit plotësisht apo 50% të saj duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës brenda afateve të përcaktuara që do të nxirret në ëëë.ust.edu.al dhe lista përfundimtare e tyre miratohet nga Bordi i Administrimit.
17. Të miratojë propozimin për tarifën e regjistrimit të aplikantëve (FSSL,FVFR) dhe tarifën e regjistrimit të fituesve(FSSL,FVFR) për ciklin e tretë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave bashkëngjitur .
18. Të miratojë propozimin për tarifën e shkollimit për studentët që do të ndjekin studimet në ciklin e tretë të studimit doktoratë për të dy fakultetet sipas tabelës bashkëngjitur.
19. Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë do të paguhet me këste.
20. Tarifën e regjistrimit në konkursin praktik, aplikimit për ciklin e dytë dhe të tretë dhe të regjistrimit të fituesve të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës www.ust.edu.al, pas miratimit nga Bordi i Administrimit.
21. Tarifën vjetore të shkollimit për të tre ciklet e studimit do të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit ëëë.ust.edu.al.
22. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron Kasa



Tab. 1

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve) Program i dytë i studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve) Program i dytë i studimeve)	2 000 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2 500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3 000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2 000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	2 000 lekë

Tab. 2**FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

Tarifa e regjistrimit ne konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve)\ Program i dytë i studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve)\ Program i dytë i studimeve)	2 000 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve)	2 500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3 000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2 000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	2 000 lekë

Tab. 3**FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT**

Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve)\ Program i dytë i studimeve)	2 000 lekë
--	------------

Tab 4

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2022-2023
Shkencat e Lëvizjes	35 000	233 916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 60 kredite në lekë për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 60 kredite në lekë për vitin akademik 2022-2023
Trajner i përgatitjes fizike	1083 (65 000)	1250 (75 000)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 120 kredite(në lekë) për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2022-2023
Shkenca Sportive (FSSL)	1750 (210000)	2125 (255 000)

Emërtimi i Programit cikli e trete të studimeve Doktoratë	Tarifa e shkollimit (për kandidatët nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit për të tjerë, në lekë
Shkenca Sportive (FSSL)	600 000	800 000

Shenim: Për arsye të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit nga MP në fushën Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar në MSH në Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor tarifa e shkollimit do të miratohet pas përgjigjes nga MASR për këtë program studimi.

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit

Tab 5

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2022-2023
Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe të rekreacionit	35 000	233 916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2022-2023
Menaxhim në Sport dhe Turizëm	1250 (75 000)	1520 (91 200)
Aktivitet Fizik dhe Rekreacion-Trainer fitness (FVFR)	1330 (79 800)	1530 (91 800)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite ne lekë për vitin akademik 2022-2023
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	1750 (210 000)	2125 (255 000)

Emërtimi i Programit cikli e trete të studimeve Doktoratë	Tarifa e shkollimit (për kandidatët nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit për të tjerë, në lekë
Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	600 000	800 000

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2022-2023	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2022-2023
Fusha Shkenca të Rehabilitimit	35 000	233 916